

FJALA E DEPUTETIT ENKELEJD ALIBEAJ

E HËNË 4 KORRIK 2022

Së pari, që të jemi korrektë me njëri-tjetrin dhe me atë që është veprimtaria e këtij institucioni të konferencës, nuk është dakordësuar. Është rënë dakord që përmbajtja të dakordësohet dhe, në dijeninë time, kemi ecur në këtë pikë, por po ju kujtoj diçka tjetër, që projektrezoluta për Kosovën, pas ndërhyrjes të disahershme timen apo edhe të deputetëve të tjerë, është lënë evazive se ku do të përfshihet, ku të diskutohet e me radhë. Ne kemi paraqitur një projekt prej shumë kohësh, i cili është depozituar pranë jush, jua kemi ofruar që ju të jepni edhe kontributin tuaj për ta parë dhe për ta studiuar, por ndodh që ajo lihet në heshtje.

Ndërkohë, duke parë edhe sjelljen tonë, besoj unë, konstruktive, po kalojmë atë të Srebrenicës, e cila duhet kaluar, por të mos lihet pa u futur ajo për Kosovën. Ato duhen futur 5 të dyja në të njëjtën datë, me të njëjtin modul dhe me të njëjtën shenjë konstruktiviteti. Ne nuk kemi përcaktuar asgjë për datën 7. Është thënë kohë më parë që të lihet data 7, sepse është para datës 11 dhe ishim dakord, por duhet futur edhe projektrezoluta që kemi paraqitur ne për dënimin e gjenocidit serb në Kosovë. Nuk dua ta përsëris, por ka kaluar edhe afati që parashikohet në Rregullore, që nga momenti që depozitohet ka një afat maksimal prej 1 muaji, i cili duhet të diskutohet në seancë dhe afati ka kaluar. Kështu që duhet të marrim masat për të dyja që të ecim dhe ta përcaktojmë.

Kam edhe diçka tjetër për sqarimin tuaj. Javën e kaluar ishte përcaktuar të ishte javë e gjelbër, kështu që duhet të jepni një sqarim pse nuk u bë javë e gjelbër. Kam edhe gjëra të tjera, por më vonë. Faleminderit!